



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

---

Nr. 10 Prot

Tiranë, më 08.02., 2013

**VENDIM Nr. 236, dt. 08.02.2013**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 08.02.2013 mbasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik", paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Sarandë për Projektin: "Ndërtimi i **Landfillit Rajonal (venddepozitimi i mbetjeve urbane)** në afërsi të fshatit Bajkaj - Palavli (Komuna Vergo), si dhe një Stacion Transferimi në Himarë", mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga **Ministria e Punëve Publike dhe Transportit**,

**VENDOSI :**

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** në bashkëpunim me **Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Sarandë** për Projektin: "Ndërtimi i **Landfillit Rajonal (venddepozitimi i mbetjeve urbane)** në afërsi të fshatit Bajkaj - Palavli (Komuna Vergo), si dhe një Stacion Transferimi në Himarë", paraqitur nga **Ministria e Punëve Publike dhe Transportit**.
- II. Të realizohen sondazhe arkeologjike të sheshit të ndërtimit, përpara fillimit të procesit të zbatimit, nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Sarandë.



Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
Web: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

---

- III. Raporti përfundimtar i sondazheve arkeologjike të paraqitet në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E  
SHERBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171

Web: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)